



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izbornni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.613/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, e ushtruar kundër Bekim Haxhiut, deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve për ta votuar subjektin e caktuar politik, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen më 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet e pasafatshme** ankesa Anr.613/2021 e datës 09.10.2021, e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, e ushtruar kundër Bekim Haxhiut, deputet në Kuvendin e Kosovës.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.10.2021, ka pranuar ankesën nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Skenderaj, në të cilën pretendohet se deputeti i Kuvendit të Kosovës Bekim Haxhiu në një tubim elektorale të organizuar nga lista “Ideal”, të mbajtur në fshatin Lubovec të komunës së Skenderajt, me qëllim që të frikësojë qytetaret ka deklaruar se *“këto zgjedhje kanë me u mbajt mend në histori. Kanë me u regjistru edhe në KQZ, me katund, në bashkësi lokale kush me kënd u kanë. O vallahi me shpi ka me u dit kush u kanë me Jasharët, me Bekim Jasharin e kush u kanë kundër tyne”*, duke i paralajmëruar se kush voton kundër listës “Ideal” do të ketë pasoja. Sipas parashtruesit të ankesës i njëjti ka cenuar të drejtën elementare kushtetuese sipas nenit par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullat Zgjedhore. Si dëshmi ka bashkangjitur një video incizim- CD nga tubimi politik i iniciativës qytetare “Ideal”.

PZAP, duke vepruar sipas dispozitës ligjore të nenit 6 par.3 të Rregullave Zgjedhore dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 10.10.2021 i ka paraqitur subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kërkesën për plotësimin e ankesës Anr.613/2021 me të cilën i

ka kërkuar këtij subjekti që të bëjë plotësimin, dhe është obliguar që ti bashkëngjisë në mënyrë më të detajuar videon e plotë të incizimit lëndor, në vendin në të cilin është mbajtur tubimi elektoral siç pretendohet në ankesë dhe kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja Me datë 11.10.2021, parashtruesi i ankesës, e ka paraqitur plotësimin e ankesës duke theksuar se rasti ka ndodhur me datë 04.10.2021, në tubimin elektoral në shollën fillore “Enver Haliti” në fshatin Lubavec Komuna Skenderaj, dhe e ka bashkangjitur video incizimin e plotë të objektit lëndor.

Paneli pas pranimit të plotësimit të ankesës, vlerësoi paraprakisht afatshmërinë e ankesës, dhe gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik PDK, kundër deputetit Bekim Haxhiu, është paraqitur në PZAP, me datë 09.10.2021, ndërsa vetë parashtruesi i ankesës në plotësimin e ankesës sipas parashtresës së datës 11.10.2021, e konfirmon se shkelja e supozuar ka ndodhur me datë 04.10.2021, e nga kjo del se ankesa është ushtruar në PZAP, pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me dispozitën e nenit 5 paragrafi 5 i Rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat e PZAP-së” në cilën përcakton se: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”*. Nga kjo rezulton se ankesa në PZAP, është ushtruar pas 24 orëve, sa ishte afati kohor për të ushtruar ankesë për llojin e shkeljes së pretenduar nga ankuesi, sepse afati kohor për paraqitjen e kësaj natyre të shkeljes së supozuar, ka rrjedhur nga momentit kur ka ndodhur shkelja e supozuar, sipas dispozitës së lartcituuar.

Paneli pasi që vlerësoi si më lartë se ankesa e parashtruar nga subjekti politik PDK, është e pasafatshme, i njëjti nuk u lëshua në vlerësimin e mëtejshëm çështjes meritorë në këtë rast.

Bazuar në arsyet e sipërsëhënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.613/2021 më datën 12.10.2021



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në afatin prej 24 orëve, nga momenti i pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.